

20150983041

L I G J

PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TE BANKA PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EVROPËS SIPAS MARRËVESHJES KORNIZË PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR NDËRTIMIN DHE MODERNIZIMIN E QENDRËS KLINIKE NËNA TEREZË NË SHKUP DHE SPITALIT RAJONAL KLINIK NË SH TIP

Neni 1

Republika e Maqedonisë merr hua te Banka për Zhvillim të Këshillit të Evropës në shumë prej 97 000 000 euro, të dedikuar për realizimin e Projektit për ndërtimin dhe modernizimin e Qendrës Klinike Nëna Terezë në Shkup dhe spitalit rajonal klinik në Shtip.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje kornizë për Projektin për ndërtimin dhe modernizimin e Qendrës Klinike Nëna Terezë në Shkup dhe spitalit rajonal klinik në Shtip, që do të lidhet ndërmjet Republikë së Maqedonisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës.

Kushtet e shfrytëzimit të mjeteve të secilës transhë veç e veç do të përcaktohen me Marrëveshje plotësuese për hua, që janë pjesë përbërëse të Marrëveshjes kornizë për hua për financimin e Projektit për ndërtimin dhe modernizimin e Qendrës Klinike Nëna Terezë në Shkup dhe spitalit rajonal klinik në Shtip.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen kornizë për hua nga neni 1 i këtij ligji do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar prej tij.

Neni 3

Afati për pagesën e huas nga neni 1 i këtij ligji është 20 vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej pesë vitesh.

Transha e parë duhet të tërhiqet në afat prej 12 muajsh nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes kornizë për hua nga neni 2 paragrafi 1 të këtij ligji dhe nuk duhet të tejkalojë 50% të shumës së përgjithshme të huas.

Tërheqja e çdo transhe vijuese do të realizohet pasi që Republika e Maqedonisë me shkrim do ta njoftojë Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës se 90% e shumës së trashës paraprake është alokuar.

Neni 4

Shkalla e kamatës do të përcaktohet për secilën transhë të huas veç e veç, në ditën e tërheqjes së mjeteve të huas, varësisht nga ajo se cila shkallë e kamatës është më e volitshme për Republikën e Maqedonisë (fikse ose variabile).

Neni 5

Projektin për ndërtimin dhe modernizimin e Qendrës Klinike Nëna Terezë në Shkup dhe spitalit rajonal klinik në Shtip do ta realizojë Ministria e Shëndetësisë.

Neni 6

Republika e Maqedonisë huan do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".